



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 143 PËR HAPJEN E ZYRËS
ZGJEDHORE TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR KOALICIONI “PARTIA DEMOKRATIKE
– ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE” AFËR QV-SË NË LAPRAKË,
TIRANË**

Sot më datë __ Maj 2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

OBJEKTI: Identifikimi i hapjes së zyrës së subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështor” afër QV 2018, në Laprakë

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi me nr. 143 ID, datë 29.4.2025.

Data: dd mmvvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 143 për hapjen e zyrës zgjedhore të subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore” në Laprakë, Tiranë

Denoncuesi pretendon se “Në rrugën S.Bruzi, Laprakë, Partia Demokratike ka hapur zyrë zgjedhore të grupseksionit 5, në distancë rreth 150 metra nga QV 2018 dhe 20181”.

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave sipas parashikimeve ligjore për mbylljen e kësaj zyre, pasi mund të ndikojë në zgjedhësit ditën e votimit.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raporti i dorëzuar nga monitoruesi rezulton se zyra zgjedhore është hapur në kundërshtim të nenit 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake Tiranë dhe Policisë së Shtetit, për e menjëhershme të zyrës zgjedhore të subjektit zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore” afër QV 2018, në rrugën “S.Bruzi”, Laprakë.
2. Ngarkohet Policia Bashkiake Tiranë dhe Policia e Shtetit për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’u njoftohet Policisë Bashkiake Tiranë dhe Policisë së Shtetit nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI